

Dorëhiqet gjyqtari i Apelit të Tiranës Alaudin Malaj

Nga [Exit News](#) 27-07-2020 në 12:15



Dorëhiqet kryetari i Gjykatës së Apelit Tiranë Alaudin Malaj. Lajmi u publikua nga Ora News, ditën e hënë. Malaj është në proces të kryerjes së rivlerësimit të figurës nga KPK që nga viti 2018.

Në dhjetor të 2019, ai tregoi në një intervistë në Top Channel se i ka kërkuar mbrotje institucioneve shqiptare për veten dhe familjen e tij.

Gjyqtari i Apelit tha se në një letër dërguar 11 institucioneve ai ka kërkuar mbrotje fizike “për shkak të rrethanave jo te zakonshme”.

Alaudin Malaj është gjyqtari që bëri publik vendimin e dënimit të Geron Xhafajt, vëllait të ish-Ministrit të Brendshëm.

Gjithashtu, Malaj ishte një nga 5 anëtarët e trupit gjykues që dhanë pafajësi për të gjithë anëtarët e organizatës “Hakmarrja për drejtësi”. Madje në 2017, Këshilli i Lartë i Drejtësisë nisi hetimin ndaj 5 gjyqtarëve të Apelit të Krimeve të Rënda, me kërkesë të ish-presidentit Bujar Nishani.